

Banka e Shqipërisë

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

TREMUJORI III - 2013

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

TETOR 2013


Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autoreve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

1.	BANKAT DHE AKTIVITETI NDËRMJETËSUES	4
2.	ECURIA E NDËRMJETËSIMIT	7
2.1	NDËRMJETËSIMI NË LEKË	7
2.2	NDËRMJETËSIMI NË VALUTË	10
3.	ECURIA E KUSHTEVE TË KREDITIMIT	14

1. BANKAT DHE AKTIVITETI NDËRMJETËSUES

Sistemi bankar përbën segmentin më të zhvilluar dhe dominues të sektorit financiar në Shqipëri. Në fund të muajit gusht 2013, aktivet e këtij segmenti zënë rreth 93% të totalit të aktiveve të institucioneve financiare në vend, duke ruajtur një raport të ngjashëm me vitin 2012. Ndërkohë, raporti i aktiveve të sistemit bankar ndaj PBB-së shënoi rritje me rreth 2 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, në 95.6%. Dominimi i tregjeve financiare nga sektori bankar e bën këtë segmentin kryesor për zhvillimin financiar dhe për transmetimin e vendimeve të politikës monetare në ekonomi dhe në inflacion. Në veçanti, reagimi i tij ndaj kushteve makroekonomike dhe rrezikut të perceptuar merr një rol të veçantë dhe të rëndësishëm për stabilitetin makroekonomik në vend. Në Shqipëri, sikurse edhe në vende të tjera të botës, mbas krizës financiare globale vëmendja e politikbërësve ekonomikë është rikthyer tek funksionimi tradicional i institucioneve bankare dhe mbështetja që ato duhet t'i japin ekonomive për t'u rimëkëmbur.




Tremujori i tretë i vitit 2013 është karakterizuar nga një rënie e rolit ndërmjetësues të sistemit bankar në Shqipëri, duke reflektuar jo vetëm ecurinë e dobët ciklike të aktivitetit ekonomik por edhe pastrimin e bilanceve të bankave nga kreditë me probleme. Ky i fundit duket se ka kushtëzuar tkurrjen e portofolit të kredisë, duke theksuar akoma më shumë dobësinë e kërkesës për financim nga sektori privat. Në muajin gusht, portfoli i kredisë së bankave ishte rreth 2% më i ulët se një vit më parë, duke kaluar në terren negativ të ritmeve të rritjes që mbas muajit korrik. Nëse do të përjashtonim fenomenin e pastrimit të bilanceve të bankave, reduktimi vjetor i kredisë për

sektorin privat do të ishte 0.6%. Ndërkohë, treguesi i kredisë së re¹, mbasi shfaqti norma pozitive rritje në fundin e tremujorit të dytë, duket të jetë rikthyer normave negative vjetore prej rreth 10% mesatarisht në muajt korrik e gusht, duke konfirmuar kështu një kërkesë të dobët për financim nga sektori bankar, si nga individët ashtu edhe nga bizneset.

Raporti i kredisë ndaj PBB-së, në fund të muajit gusht, vlerësohet të jetë rreth 40%, ose 1.2 pp më i ulët se një vit më parë. Tkurrja e ndjeshme e portofolit të kredisë në dy muajt e fundit ka përcaktuar dhe rënien më të dukshme të raportit të kredisë ndaj PBB-së. Nga ana tjetër, ritmet e rritjes së aktivitetit ekonomik në vend janë ngadalësuar dhe vlerësohet të jenë dukshëm nën nivelin potencial. Kjo ecuri, së bashku me pasigurinë e lartë të perceptuar nga agjentët ekonomikë, ka rezultuar në një kërkesë më të ulët për financim. Paralelisht me këto zhvillime, sistemi bankar, edhe pse shfaq tregues të shëndetshëm të përfitueshmërisë dhe kapitalizimit, vazhdon të jetë përzgjedhës në projektet që financon.

Tkurrja e ndjeshme e aktivitetit kreditues është shoqëruar edhe me një krijim më të pakët të parasë në ekonomi. Krahas këtij fenomeni, edhe prurjet valutore nga jashtë janë reduktuar, duke përcaktuar edhe ecurinë e dobët të depozitave në valutë, veçanërisht në tremujorin e tretë. Në tërësi, këto zhvillime kanë kushtëzuar ngadalësimin e ritmeve të rritjes së depozitave, duke ndikuar në rënien e raportit të depozitave ndaj PBB-së. Ky raport shënonte 69.8% në muajin gusht, përkundërt 70.7% që shënonte një vit më parë. Gjithsesi, tkurrja e këtij treguesi përgjatë vitit 2013 shfaqet e luhatshme dhe më e moderuar se raporti i kredisë, për shkak të rolit më aktiv të bankave në grumbullimin e depozitave, si dhe të krijimit të parasë nëpërmjet mbështetjes me financim nga banka të aktivitetit të qeverisë.



¹ Zhvillimet e kredisë së re të disbursuar në muaj vlerësohen si një tregues që është më afër kërkesës për kredi nga klientët e bankave.

Në muajin gusht depozitat në total paraqiten 1.9% më të larta se një vit më parë. Kjo normë rritjeje i është përmbajtur prirjes ngadalësuese të vërejtur që në verën e vitit 2012. Krahasuar me fundin e vitit 2012, ato janë rritur me 17.3 miliardë lekë, duke reflektuar rritjen e depozitave të individëve në lekë dhe të depozitave të bizneseve, kryesisht pa afat. Këto të fundit duket të kenë reflektuar edhe aktivitetin e shtuar të sektorit fiskal. Ndërkohë që normat vjetore të rritjes së depozitave të individëve kanë ruajtur trendin e tyre rënës. Kjo ecuri ka reflektuar jo vetëm tkurrjen e të ardhurave të disponueshme, por edhe prurjet më të ulëta nga remitancat². Fenomeni i zhvendosjes së kursimeve drejt institucioneve financiare jobanka duket të jetë më pak i pranishëm se në gjashtëmujorin e parë.

Paralelisht me këto zhvillime, raporti i kredisë ndaj depozitave ka vazhduar të tkurret. Në fund të muajit gusht ky raport u reduktua në 57.5%, krahasuar me 59% që rezultonte në fund të tremujorit të dytë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë ai rezulton rreth 2 pikë përqindje më i ulët.

Zhvillimet në aktivitetin ndërmjetësues, krahas faktorëve të lidhur me aktivitetin ekonomik në vend kanë reflektuar edhe strategjitë e bankave në sistem. Sistemi bankar dominohet nga bankat e huaja, të cilat përfaqësojnë rreth 90% të sistemit bankar. Për pasojë politikat e kreditimit të bankave në vend janë ndikuar edhe nga politikat e bankave mëma, në veçanti ato me prejardhje evropiane. Kështu, ndërmjetësimi financiar sipas grup-bankave në muajt korrik- gusht ka konfirmuar ecurinë e dy-tre viteve të fundit.


² Të dhënat e tremujorit të dytë tregojnë se remitancat kanë pësuar një tkurrje të fortë (-39%), krahasuar me një vit më parë.

2. ECURIA E NDËRMJETËSIMIT

Aktiviteti ndërmjetësues në muajt korrik dhe gusht është karakterizuar nga tkurrja e ndërmjetësimit, si në monedhën vendase ashtu edhe në valutë, e ndikuar nga zhvillimet në portofolin e kredisë. Kjo tkurrje shfaqet më e theksuar për aktivitetin ndërmjetësues në valutë. Bankat vijojnë të jenë konservatore në politikat e tyre të kreditimit, të ndikuara njëkohësisht nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, gjë që vihet re në shtrëngimin e kushteve të kreditimit. Marzhet e ndërmjetësimit janë shfaqur të luhatshme të ndikuar nga politikat preferenciale dhe përzgjedhëse të bankave për klientë të caktuar. Në një këndvështrim më afatgjatë, gjerësisht ato kanë mbetur të pandryshuar, duke kufizuar tejçimin e sinjaleve monetare lehtësuese në kanalin e kredisë e më tej në ekonomi dhe në inflacion.


2.1 NDËRMJETËSIMI NË LEKË

Në muajt korrik dhe gusht, ndërmjetësimi në monedhën vendase ka ndjekur trendin rënës të shfaqur në tremujorin e dytë të vitit 2013. Në fund të muajt gusht, raporti kredi/depozita në lekë shënoi 42.9%, duke rënë me 0.4 pikë përqindje kundrejt fundit të tremujorit të dytë. Rënia e raportit të ndërmjetësimit në lekë, gjatë muajve korrik dhe gusht, është rezultante nga njëra anë e ngadalësimit të dukshëm të normave të rritjes së kredisë në lekë, dhe nga ana tjetër e përmirësimit të ritmeve të rritjes së depozitave në lekë gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë që ai ka mbetur i pandryshuar nga niveli i një viti më parë.




Depozitat në lekë, në tremujorin e tretë të vitit, kanë vijuar të ndjekin një trajektore rritëse në terma vjetorë. Në fund të muajit gusht, stoku i depozitave në monedhë vendase rezulton rreth 6.6% më i lartë se një vit më parë. Zgjerimi i tyre është mbështetur nga krijimi më i lartë i parasë në lekë, në sajë të aktivitetit të shtuar të qeverisë në tregun e brendshëm dhe kreditimit më të lartë të sektorit privat në lekë, krahasuar me valutën. Megjithatë, ecuria e depozitave në lekë në terma më afatshkurtër paraqet një kontraktim të stokut në muajin korrik dhe një zgjerim të ulët të tij në muajin gusht. Në fund të kësaj periudhe, stoku i tyre rezulton rreth 0.3 miliardë lekë më i lartë se në muajin qershor. Kjo sjellje është ndikuar nga kontraktimi i aktivitetit fiskal në këto muaj, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Pjesërisht ajo është ndikuar edhe nga huadhënia më e ulët e sistemit bankar për agjentët ekonomikë privatë në monedhë vendase, për të njëjtën periudhë. Kontribut në rritjen e depozitave në lekë kanë dhënë depozitat e biznesit, të cilat përgjithësisht karakterizohen nga një luhatshmëri e lartë. Kjo kategori ka pësuar kryesisht zgjerim të depozitave me afat. Ndërkohë, depozitat e individëve duket të kenë një zhvendosje drejt maturiteteve më të ulëta.

Grafik 4. Depozitat në lekë, sipas agjentëve ekonomikë dhe sipas afateve të maturimit.



Kredia në lekë përbën 39.2% të totalit të kredisë në fund të muajit gusht, duke vazhduar të rrisë peshën e saj në portofolin e sistemit bankar. Megjithatë, gjatë vitit 2013, normat e rritjes së këtij portofoli janë ngadalësuar nga njëri tremujor në tjetrin, duke zbritur në 6.5% në muajin gusht, përkundrajt 8.4% dhe 14% që shënonin përkatësisht në fund të tremujorit të dytë dhe në fund të vitit 2012. Kështu, teprica e kredisë në lekë në muajin gusht ishte rreth 1.6 miliardë lekë më e ulët se në fund të gjashtëmujorit të parë. Ngadalësimi i kredisë në lekë, në veçanti në muajin gusht, ka reflektuar norma më të ulta rritje të kredisë për individë për qëllime konsumi. Kjo reflekton edhe procesin e pastrimit të portofolit të kredisë së bankave nga kreditë pa shpresa arkëtimi. Ndërkohë, kreditimi në lekë për biznese ka ruajtur normë të qëndrueshme të ritmeve vjetore në 9.4%, ku ngadalësimi i kredisë për investime në lekë është kompensuar nga ritmi më i lartë i rritjes së kredisë për likuiditet në lekë.


Grafik 5. Ecuria e aktivitetit kreditues në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka ndjekur tendencën rritëse deri në muajin korrik, duke shënuar nivelin më të lartë për vitin 2013 në 7.3 pikë përqindjeje, dhe më pas është reduktuar dukshëm në muajin gusht në 5.8 pikë përqindjeje. Kjo sjellje është diktuar nga rënia e vazhdueshme e normave të interesit të depozitave përgjatë vitit, ndërkohë që interesi mesatar i kredisë në lekë është luhatur në nivele të qëndrueshme, rreth 11% deri në muajin korrik. Më pas në muajin gusht, norma mesatare e interesit të depozitave në lekë prej 3.7% është shoqëruar nga një rënie e fortë në normën e interesit të kredisë, në 9.48%, duke përcaktuar tkurrjen e marzhit të ndërmjetësimit. Krahasuar me një vit më parë, në fund të muajit gusht marzhi i ndërmjetësimit është 0.5 pp më i ulët. Gjithsesi, norma e interesit të kredisë, e ndikuar edhe nga niveli i ulët i kredive të disbursuara, është lehtësisht e ekspozuar nga normat preferenciale të një banke për klientë të veçantë. Nëse do të përjashtonim zhvillimet e muajit gusht, kostoja mesatare e ndërmjetësimit mbetet në terma lehtësisht më të larta se mesatarja e vitit 2012.

Grafik 6. Ecuria e koston së ndërmjetësimit në lekë*.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë/depozitave dhe asaj referencë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe Euribor 12-mujor për euron).

Normat e interesit të kredisë në lekë përgjithësisht janë të indeksuara me normën e interesit të bonove të thesarit 12M. Gjatë muajve korrik dhe gusht, kjo e fundit ndoqi trendin rënës të nisur që në fillim të vitit, por me ritme më të përshpejtuar, duke u zvogëluar deri në 4.73% dhe duke shënuar një rënie prej 0.83 pp brenda dy muajve. Kjo ecuri ka reflektuar, krahas rënies së kërkesës për financim nga qeveria, edhe reduktimin më të fundit të normës bazë të interesit me 0.25, pp në muajin korrik. Ndërsa interesat e kredisë në lekë, vetëm në muajin gusht, shfaqën një rënie të fortë, e cila është reflektuar edhe në rënien e diferencës së normës së interesit të kredisë nga yield-i i bonove. Në fund të muajit gusht, kjo diferencë shënonte 4.75 pp, përkundrajt 5.2 pp që shënoi mesatarisht në tremujorin e dytë. Në terma mesatarë për të gjithë vitin kjo, diferencë është 0.93 pp më e lartë se mesatarja për vitin 2012, kjo pasi interesat e kredisë nuk kanë rënë me shpejtësinë e rënies së yield-eve të letrave me vlerë të qeverisë.


2.2 NDËRMJETËSIMI NË VALUTË

Raporti i ndërmjetësimit në valutë ka shfaqur rënie në tremujorin e tretë të vitit në 73.7%, ose 1.3 pp më i ulët se në fund të vitit 2012. Ky zhvillim është kushtëzuar nga aktiviteti i moderuar financiar në monedhë të huaj, gjatë kësaj periudhe. Pakësimi i kreditimit të agjentëve ekonomikë privatë në valutë, paralelisht me reduktimin e flukseve hyrëse valutore nga jashtë, janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në krijimin e ulët të parasë në ekonomi në monedhë të huaj.




Stoku i depozitave në valutë gjatë kësaj periudhe ka shënuar tkurrje në terma vjetorë, me 1.4% dhe 2.8%, përkatësisht në muajt korrik dhe gusht. Krijimi i ulët në monedhë të huaj është diktuar gjithashtu nga reduktimi i portofolit të kredisë për sektorin privat në valutë, si dhe nga ngadalësimi i flukseve valutore nga sektori i jashtëm. Ndërkohë, stoku i depozitave në valutë në muajin gusht ka shënuar rritje, duke amortizuar pjesërisht reduktimin

e tyre gjatë vitit. Kjo ecuri është ndikuar nga sjellja sezonale e tyre gjatë kësaj periudhe, si pasojë e flukseve valutore hyrëse në formën e remitancave. Ajo është reflektuar në zgjerimin e depozitave në valutë të individëve, kryesisht në ato pa afat. Ndërkohë, kategoria e depozitave të biznesit shënon zgjerim të stokut në valutë, sidomos në muajin gusht, në linjë me zhvillimet sezonale, si pasojë e arkëtimeve më të mëdha të bizneseve, kryesisht në industrinë e turizmit. Struktura kohore e depozitave në valutë, sikundër dhe e atyre në lekë, tregon për një zhvendosje të tyre drejt maturiteteve më të ulëta, duke nënkuptuar një nevojë në rritje të agjentëve ekonomikë për mjete monetare më likuide.



Kredia në valutë, në fund të muajit gusht, ishte rreth 9 miliardë më e ulët se në fund të vitit 2012. Ndërkohë që ndryshimi vjetor i portofolit u thellua më tej në - 5.7%, i ndikuar nga rënia e fortë e kredisë në valutë për biznese. Krahas kërkesës së dobët për kredi nga agjentët ekonomikë, në veçanti për investime, kjo ecuri ka shfaqur edhe pastrimin e bilancit të bankave nga kreditë me probleme. Paralelisht me këto zhvillime, kushtet e kreditimit vazhdojnë të jenë të shtrënguara, në veçanti për bizneset. Kjo ecuri duket të jetë mbështetur edhe nga politikat e bankave për financimin e klientëve të tyre me të njëjtën monedhe që kanë të ardhurat.


Grafik 9. Ecuria e aktivitetit kredites në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro³ vijon të jetë e luhatshme nga muaji në muaj. Në terma mesatarë, në muajt korrik dhe gusht, ajo rezultoi 5.2 pikë përqindje, duke qëndruar pranë niveleve të tremujorit të dytë. Interesi mesatar i depozitave në euro, prej 1.76%, ka ardhur lehtësisht në rënie. Deri në muajin gusht, ky interes ishte mesatarisht 0.7 pp më poshtë se sa një vit më parë. Ndërkohë, normat e interesit për kredinë në euro, prej rreth 7%, shënuan rënie prej 0.3 pp për të njëjtën periudhë. Rënia më e shpejtë e normës së interesit të depozitave në euro, përkundrajt reduktimit të interesit të kredisë, ka çuar në rritje me rreth 0.5 pikë përqindjeje të kostonë së ndërmjetësimit në valutë, krahasuar me mesataren e vitit 2012.

Grafik 10. Ecuria e kostonë së ndërmjetësimit në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


³ Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.

Po kështu, diferenciali i normës së interesit të kredisë në euro, krahasuar me normën referencë të Euriborit në tregjet ndërkombëtare, është rritur krahasuar me një vit më parë, si rezultat i normave mesatarisht të larta të interesit të kredisë në euro dhe ruajtjes në nivele të ulëta të interesit në euro, në tregjet ndërkombëtare.

3. ECURIA E KUSHTEVE TË KREDITIMIT

Kushtet e kreditimit për bizneset dhe individët vijojnë të jenë të shtrënguara edhe në tremujorin e tretë të vitit. Në kahun shtrëngues kanë vepruar si elementët çmim të kredisë (norma e interesit, komisionet), ashtu edhe elementët jokosto të saj.

Në tremujorin e tretë të vitit, bankat raportojnë për mbajtjen në nivele të shtrënguara të kushteve të kreditimit të bizneseve. Kjo ecuri ka reflektuar shqetësimin e tyre për situatën makroekonomike në vend, në veçanti rrezikun për sektorë të caktuar të ekonomisë dhe njëkohësisht nivelin e lartë të kredive me probleme. Politika shtrënguese e bankave, gjatë tremujorit të tretë, është realizuar kryesisht nëpërmjet zgjerimit të marzhit për kreditë me rrezik dhe uljes së madhësisë së kredisë. Nga ana tjetër, ngushtimi i marzhit mesatar, ulja e kërkesës për kolateral në raport me madhësinë e huasë, ulja e komisioneve, si dhe rritja e maturitetit maksimal të kredisë në këtë tremujor, kanë ndihmuar disi në zbutjen e standardeve të kredidhënies.



Ndërkohë, standardet e kredisë për individë janë vlerësuar nga bankat lehtësisht si më të shtrënguara. Kjo ecuri ka pasqyruar shqetësimin e tyre për situatën e përgjithshme makroekonomike dhe në veçanti, ecurinë e portofolit të kredive të këqija. Kushtet që kanë përdorur bankat për tejçimin e sinjaleve shtrënguese kanë qenë rritja e marzhit për kreditë me rrezik dhe ulja e sasisë së kredisë së dhënë, ndërkohë që pjesa tjetër e standardeve ose nuk kanë ndryshuar ose janë disi në kahun lehtësues.